

UDHËZIM
Nr.17, datë 28.9.2011

PËR ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS SË PUNËTORËVE TË LËVIZSHËM NË
AVIACIONIN CIVIL

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi në Republikën e Shqipërisë, i kohës së punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.

2. Në përputhje me këtë udhëzim sipërmarrjet e aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë, do të zbatojnë rregullat e vendosura në Marrëveshjen europiane mbi organizimin e kohës së punës të stafit të lëvizshëm në aviacionin civil të arritur më 22 mars 2000, ndërmjet organizatave përfaqësuese të drejtuesve dhe fuqisë punëtore në sektorin e aviacionit civil, të cilat janë:

- Organizata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE),
- Federata e Punëtorëve Europianë të Transportit (FPET),
- Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK),
- Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL),
- Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA),

Rregullat specifike mbi të cilët është arritur marrëveshja janë paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila është pjesë integrale e tij.

Neni 2

1. Sipërmarrjet e aviacionit civil mund të ruajnë ose zbatojnë rregulla më të favorshëm se ata të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Zbatimi i këtij udhëzimi në asnjë rrethanë nuk përbën bazë të mjaftueshme për të justifikuar një reduktim në nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes së punëtorëve në fushat e mbuluara nga ky udhëzim.

3. Zbatimi i këtij udhëzimi nuk cenon të drejtën e organeve kompetente, drejtuesve apo fuqisë punëtore që, në rrethana të ndryshme, të përcaktojnë masa legjislative, rregulluese ose kontraktuale të veçanta nga ato të vendosura në këtë udhëzim, me kusht që gjithmonë kërkesat minimale të përcaktuara në këtë udhëzim të zbatohen.

Neni 3

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil që brenda datës 1 shtator 2012 të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi në sektorin e aviacionit civil.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

SHTOJCË

Në përputhje me parashikimet e marrëveshjes europiane mbi organizimin e kohës së punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil të arritur më 22 mars 2000, ndërmjet organizatave përfaqësuese të

drejtuesve dhe fuqisë punëtore në sektorin e aviacionit civil: Organizata e Linjave Ajrore Europiane (SHLAE), Federata e Punëtorëve Europeanë të Transportit (FPET), Shoqata Europiane Kabina/Cockpit (SHEK), Shoqata Europiane e Linjave Rajonale (SHELRL) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Transportuesve Ajrorë (SHNTA), në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen rregullat dhe përcaktimet si më poshtë:

1.1 Këto rregulla zbatohen për kohën e punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.

1.2 Kjo shtojcë përmban rregulla më specifike brenda kuptimit të legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë, lidhur me kohën e punës së stafit të lëvizshëm në aviacionin civil.

2.1 “Kohë pune” nënkupton çdo periudhë gjatë së cilës i punësuar punon, në dispozicion të punëdhënësit, duke kryer detyrat dhe aktivitetet e tij, në përputhje me ligjet kombëtare.

2.2 “Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil” nënkupton anëtarët e ekuipazhit në një avion civil, të punësuar nga një sipërmarrje të krijuar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të ZPEA-së.

2.3 “Koha e fluturimit bllok” nënkupton kohën ndërmjet lëvizjes së parë të një avioni nga vendi i tij i parkimit, me qëllim ngritjen, derisa ai kthehet për të pushuar në vendin e parkimit të përcaktuar dhe deri sa të gjithë motorët të kenë ndaluar.

3.1 Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e lejes vjetore të paguar prej katër javësh të paktën sipas kushteve të dhënies së të drejtës së një lejeje të tillë të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar.

3.2 Koha minimale e lejes vjetore të paguar nuk mund të zëvendësohet me një ndihmë financiare në vend të saj, përjashtoj rastin kur marrëdhënies së punësimit i jepet fund.

4.1 Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil gëzon të drejtën e kontrollit shëndetësor falas para marrjes së detyrës dhe më vonë gjatë intervaleve të rregullta.

4.2 Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil, i cili vuan nga probleme shëndetësore që dihet se kanë lidhje me faktin se ata punojnë natën, do të transferohen kur të jetë e mundshme në ditë pune të lëvizshme ose të palëvizshme në të cilën ata përshtaten.

4.3 Kontrolli shëndetësor falas i përmendur në paragrafin 4.1 pajtohet me konfidencialitetin mjekësor.

4.4 Kontrolli shëndetësor falas i përmendur në paragrafin 4.1 mund të realizohet brenda sistemit shëndetësor kombëtar.

5.1 Stafi i lëvizshëm në aviacionin civil do të ketë mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë sipas natyrës së punës.

5.2 Mbrojtja e duhur dhe shërbime parandaluese ose lehtësuese lidhur me shëndetin dhe sigurinë e stafit të lëvizshëm në aviacionin civil do të jenë në dispozicion gjatë gjithë kohës.

6. Masa të nevojshme do të ndërmerren për të siguruar se një punëdhënësi, i cili ka për qëllim të organizojë punën sipas një sistemi të caktuar, merr në konsideratë parimin e përgjithshëm të përshtatjes së punës.

7. Të dhënat lidhur me sistemet specifike të punës së punonjësve të lëvizshëm në aviacionin civil u sigurohen autoriteteve kompetente nëse ata e kërkojnë këtë.

8.1 Koha vjetore maksimale e punës, duke përfshirë disa elemente të zëvendësimit për caktim me detyrë siç përcaktohet nga ligji në fuqi, përbëhet nga 2000 orë në të cilën koha bllok e fluturimit është e kufizuar në 900 orë.

8.2 Koha vjetore maksimale e punës shpërndahet sa më e barabartë dhe praktike gjatë gjithë vitit.

9. Pa cenuar pikën 3, stafit të lëvizshëm në aviacionin civil u jepen ditë të lira nga çdo lloj detyre dhe zëvendësimi, të cilat u njoftohen para kohe, si më poshtë:

a) të paktën shtatë ditë lokale në çdo muaj kalendarik, të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushimi të parashikuar me ligj; dhe

b) të paktën 96 ditë lokale çdo vit kalendarik, të cilat mund të përfshijnë çdo periudhë pushimi të parashikuar me ligj.